



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2024/0492

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga Batisha Ibrahimimi, paneliste individuale duke vendosur sipas ankesës së OE GJEO-PROJEKT SH.P.K, kundër Vendimin për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit lidhur me aktivitetin e prokurimit “Platforma digjitale në GIS për infrastrukturë rrugore” me numër të prokurimit 632-23-14222-1-2-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – KOMUNA E GJAKOVËS, më 09.08.2024, mori këtë:

Vendim

1. Refuzohet, si e pabazuar ankesa e GJEO-PROJEKT SH.P.K me nr. 2024/0492 , e datës 08.06.2024, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Platforma digjitale në GIS për infrastrukturë rrugore”, me numër të prokurimit 632-23-14222-1-2-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – KOMUNA E GJAKOVËS.
2. Mbetet ne fuqi Njoftimi mbi Vendimin të Autoritetit Kontraktues -KOMUNA E GJAKOVËS lidhur me aktivitetin e prokurimit me të dhënat si në pikën I të dispozitivit.
3. Urdhërohet konfiskimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar nga operatori ekonomik ankues bazuar në nenin 31 par. 5 të Rregullores së Punës së OSHP ndërsa mjetet kalojnë në buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

-Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 21.12.2023 KOMUNA E GJAKOVËS në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Platforma digjitale në GIS për infrastrukturë rrugore” me numër të prokurimit 632-23-14222-1-2-1. Ndërsa me datë 20.05.2024 AK ka publikuar B58 Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues ku ka shpërblyer me kontratë Operatorin Ekonomik GJEO-LAND SH.P.K.

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratës shërbime dhe me vlerë të parashikuar të kontratës 40,000.00 euro.

Me 25.05.2024 OE GJEO-PROJEKT SH.P.K, ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Me 30.05.2024 Autoriteti Kontraktues ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 08.06.2024, OSHP ka pranuar ankesën nga OE GJEO-PROJEKT SH.P.K, me nr. 492/2024 lidhur me aktivitetin “Platforma digjitale në GIS për infrastrukturë rrugore” me numër të prokurimit 632-23-14222-1-2-1.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues GJEO-PROJEKT SH.P.K, janë parashtruar si në vijim:

Në kërkesën për rishqyrtim të dorëzuar nga Operatori Ekonomik (OE) GJEO-PROJEKT SHPK, është evidentuar se Autoriteti Kontraktues (AK) ka refuzuar OE-në në projektin e Platformës Digjitale në GIS për infrastrukturën rrugore, duke pretenduar se nuk është dorëzuar certifikata GIS për menaxherin e projektit.

OE GJEO-PROJEKT SHPK ka konstatuar se kjo përgjigje e AK është jo korrekte dhe e diskriminueshme, duke pretenduar se AK ka kontradikta në vlerësimin e dokumentacionit të dorëzuar. Gjatë procesit të rishqyrtimit, AK ka ndryshuar kriteret e dosjes së tenderit lidhur me çertifikatën GIS, duke kërkuar specifikisht certifikimin nga organizata ose instituti për modulet e GIS-it.

OE GJEO-PROJEKT SHPK argumenton se ata kanë dorëzuar dokumentacionin e nevojshëm për çertifikimin e stafit të tyre në kuadër të dosjes së tenderit, përfshirë Çertifikatën për inxhinierin që është i çertifikuar në GIS softuerin Global Mapper dhe se kompania ka marrëveshje me Blue Marble si pronar të softuerit GIS Global Mapper. Megjithatë, AK ka pranuar çertifikatat e OE-të tjera të rekomanduara për kontratë, të cilat kanë përfunduar kurse online vetëm për disa module të caktuara në kompaninë Esri.

GJEO-PROJEKT SHPK vlerëson se vendosja e kriterëve shtesë gjatë fazës së vlerësimit është shkelje ligjore dhe diskriminim i qartë i tyre. Ata gjithashtu theksojnë se menaxherja e tyre e projektit ka titullin e Master Shkencor në Gjeodezi Inxhinjerie dhe se nuk është e nevojshme që ajo të jetë e çertifikuar në module të veçanta të GIS-it përveç diplomës së saj akademike. GJEO-PROJEKT SHPK gjithashtu konsideron se AK nuk ka kryer një analizë të plotë të dokumentacionit dhe krahasimit të tij në përputhje me ligjin.

Për më tepër, AK është refuzuar certifikatat e kompanisë GJEO-PROJEKT SHPK, e cila ka marrëveshje me Blue Marble, një autoritet në fushën e softuerit GIS, në kontrast me pranimin e certifikatave të kompanisë Esri. Kjo sjell pyetjen se pse preferohen certifikatat e kompanisë Esri në vend të atyre të Blue Marble, duke i privuar kështu GJEO-PROJEKT SHPK nga mundësia e marrjes së kontratës.

Bazuar në argumentet dhe faktet prezantuar, kërkesa e OE GJEO-PROJEKT SHPK për rishqyrtim të vendimit të AK për refuzimin e tyre në projektin e Platformës Digjitale në GIS për infrastrukturën rrugore është mbështetur në dokumentacionin e duhur dhe në shkelje të qartë të procedurave ligjore nga ana e AK.

Duke u referuar pretendimeve si më sipër GJEO-PROJEKT SH.P.K, konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me LPP të RK 04/l-042 Neni 1, Neni 7, Neni 59, Neni 60, Neni 69, Neni 72, dhe në kundërshtim me rregulloren 001/2022 Neni 27, Neni 28, Neni 40 dhe Neni 51.

Përgjigje në kërkesën për rishqyrtim:

Refuzohet si e pabazuar kërkesa për ri-shqyrtim e OE, GJEO-PROJEKT SHPK, e datës 27.05.2024, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull Platforma digjitale ne GIS për infrastrukturën rrugore, nr prokurimit:632-23-14222-1-2-1, nr i mbrendshem:632-23-201-121, kundër njoftimit mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues të datës 20.05.2024, të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së. Vërtetohet Njoftimi mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues i publikuar më datën 20.05.2024. Autoriteti kontraktues, vendos që të vazhdoj aktivitetin e prokurimit. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe publikohet në platformën elektronike të KRPP-së.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Organi Shqyrtues i Prokurimit me datë 20.06.2024 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 492/2024, ndërsa me datë 03.07.2024 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2024/397 me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues refuzohet si e pabazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK deklaron se Pajtohet rreth rekomandimeve të raportit të ekspertit shqyrtues, ndërsa OE nuk është pajtuar lidhur me raportin e ekspertit shqyrtues.

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore ne kuptim të nenit 24 paragrafi 1 të Rregullores së Punës së OSHP-së duke marr parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin merititor lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave -

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtresat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE GJEO-PROJEKT SH.P.K, eksperti shqyrtuese përmes raportit nr. 2024/492 ka vlerësuar si në vijim:

Konstatimi i parë (I): Operatori ekonomik ankues pretendon se Autoriteti Kontraktues (AK) ka bërë shkelje në procedurën e vlerësimit duke e eliminuar ata për mosdorëzimin e një certifikate GIS për menaxherin e projektit, siç është kërkuar në dosjen e tenderit.

- AK kishte kërkuar që menaxheri i projektit të jetë i certifikuar për GIS me përvojë pune në projekte të tilla.
- Operatori ekonomik ka ofruar një certifikatë të lëshuar nga vetë OE GJEO-Projekt.

Përgjigja e OE-së ankuese është se ata kanë të drejtën për të certifikuar stafin e tyre në Softuerin Global Mapper, ndërsa kërkesa e AK-së kishte specifikuar një menaxher të certifikuar për GIS.

- Gjykim: Pretendimi i OE-së për mosbazuarinë e vlerësohet si i pa bazuar. AK ka kërkuar specifikisht një certifikim për GIS, jo vetëm për Softuerin Global Mapper.

Konstatimi i dytë: OE ankues pyet pse AK pranon certifikatat e kompanisë ESRI dhe jo ato të GJEO-PROJEKT SHPK, e cila ka marrëveshje me Blue Marble, një autoritet në fushën e GIS.

- OE rekomanduar për kontratë ka ofruar edhe një certifikatë për mbajtjen e trajnimit 6-javor për GIS nga Earth Observation Institute (EOI).
- Gjykim: Pretendimi është se OE ankues nuk ka dorëzuar certifikatën nga Blue Marble, por nga vetë kompania, e cila nuk plotëson kriteret e kërkuara nga AK për një menaxher të certifikuar për GIS. Pas vlerësimit të pretendimeve të OE GJEO-Projekt SHPK, eksperti shqyrtues rekomandon që të mbetet në fuqi vendimi i AK-së për të mos dhënë kontratën dhe konsideron ankesën e OE të pa bazuar në bazë të argumenteve dhe dokumentacionit të prezantuar.

Rrjedhimishtë, Paneli shqyrtues ka administruar provat e prezentuara ne ofert dhe po ashtu ne ankesën e deponuar ne OSHP , dhe konstaton se autorizimi i dorezuar nga BLUE MARBLE, është e dates 04.03.2024, ndersa hapja e ofertave ka qen me daten : 11.01.2024, autorizimi është prezentuar pas hapjes se ofertave e qe bie ndesh me nenin 59 , e cila nuk ka qen pjesë integrale e ofertës së dorezuar , dhe se edhe nese do të kërkohet sqarim sipas nenit 72 te LPP-se, prap data e autorizimit është në kundërshtim me nenin 38 , paragrafi 38.3 te RRPP-se.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli Shqyrtues duke i analizuar shkresat e kësaj lënde dhe veprimet e ndërmarra nga palët, deklaratat e tyre dhe provat e administruara gjatë rrjedhës së këtij aktivitetit të prokurimit, konsideron se gjetjet e ekspertit shqyrtues mendimet e tij janë të pranueshme dhe se Paneli Shqyrtues me të drejtë e mori në konsideratë Raportin e tij me rastin e vendosjes .

Në rastin konkret nga raporti i ekspertit shqyrtues, dëshmitë e prezentuara nga operatori ekonomik ankues, dokumentet e dosjes së tenderit si dhe nga provat tjera të rastit është gjetur se të gjitha pretendimet ankimore janë të pabazuara. Duke u bazuar në gjendjen faktike të

konstatuar si më sipër, Paneli Shqyrtues i ka falur besimin e plotë konstatimeve dhe rekomandimeve në raportin e ekspertit shqyrtues. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka gjetur se të gjitha pretendimet e operatorit ekonomik ankues janë të pabazuara.

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit, ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik duhet të refuzohet si e pabazuar. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur të mbetet në fuqi Vendimi i Autoritetit Kontraktues KOMUNA E GJAKOVËS lidhur me aktivitetin e prokurimit me “Platforma digjitale në GIS për infrastrukturë rrugore” me numër të prokurimit 632-23-14222-1-2-1.

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Për pikën I të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën III të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 5 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Batisha Ibrahim

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KOMUNA E GJAKOVËS**
- **OE - GJEO-PROJEKT SH.P.K**
- Arkivës së OSHP-së: